

bulevardi, Cjergj Fishia, (ish upv m.2)
të. 068 20 16 816
info@universiteeuropian.com
www.universiteeuropian.com



**Universiteti
Europian i
Tiranës**

Tema 2

ANALIZA E PASQYRES SE TE ARDHURAVE DHE PASQYRES SE BILANCIT

Pasqyra e te Ardhurave

Perkufizim: Pasqyra e te ardhurave prezanton rezultatin financiar te kompanise gjate nje periudhe te caktuar e cila quhet periudhe kontabile.

Rendesia e Pasqyres se te Ardhurave

1. Vlereson performancen e kaluar te kompanise.
2. Ofron bazat per te parashikuar te ardhmen.
3. Ndhmon ne vleresimin e riskut apo pasigurise per te realizuar flukse te ardhshme te parase.


Kufizimet e Pasqyres se te Ardhurave

1. Elementet qe nuk mund te maten nuk raportohen ne pasqyren e te ardhurave.
2. Matja e te ardhurave varet nga metoda kontabile e perdorur.
3. Ne matjen e te ardhurave perfshihet gjykimi.

Pasqyra me Shume Hapa

- Informacioni prezantohet ne disa grupe kryesore ne pasqyre.
- Ne pasqyre dallon aktivitetin operacional nga aktiviteti jo operacional.
- Operacionet periodike jane treguar vecmas operacioneve jo periodike.
- Efektet e tatimit po ashtu prezantohen vecmas.

Pasqyra me shume hapa



Formati i Pasqyres se te Ardhurve

	Te ardhura nga shitja e te mirave dhe sherbimeve
-	Kosto e mallrave te shitura
	Fitimi Bruto (Marzhi bruto) -Shpenzimet e marketingut dhe shitjes -Shpenzimet adiminstrative
+	Te ardhura te tjera
	Fitimi nga operacionet perpara interesit dhe taksave (EBIT)
-	Kostot financiare (INTERESAT)
	Fitimi periodik (para taksave) nga operacionet e vazhdueshme (EBT)
+/-	Te ardhura te pazakonshme ose jo frekvente
	Fitimi neto nga operacionet e vazhdueshme para tatimit
-	Shpenzimet e takses mbi te ardhurat
	Fitimi neto nga operacionet e vazhdueshme
+/-	Te ardhura nga operacionet e nderprera (raportuar neto nga taksat)
+/-	Njesi te jashtezakonshme (raportuar neto nga taksat)
+/-	Efekti kumulativ i ndryshimeve ne metodat kontabile (raportuar neto nga taksat)
	E ardhura neto (EAT)

Perkufizimi i te Ardhurave

- **Te Ardhurat:** jane rritja e benefiteve gjate nje periudhe kontabile, te cilat rezultojne ne rritjen e kapitalit te vet, vec rasteve te rritjes se kapitalit si rrjedhim i derdhjeve nga vete aksioneret.

Parimi i Pergjithshem i Njohjes se te Ardhurave

Te ardhurat duhet te njihen kur plotesohen te dy kushtet:

- 1) Kompletimi i procesit te fitimit te te ardhurave.
- 2) Siguria e Pageses.

Parimi i Pergjithshem i Njohjes se te Ardhurave

- ***Kompletimi i procesit te fitimit te te ardhurave*** – Firma duhet te kete ofruar pergjithesisht te gjithe sherbimet apo te mirat per te cilat duhet paguar dhe kostoja e pritur e sherbimeve apo te mirave duhet te jete e matshme.
- ***Siguria e pageses*** – Kompania duhet te jete ne gjendje te vleresoje probabilitetin e pageses.

Parim i Pergjithshem i Njohjes se Shpenzimeve

Parimi i pershtatjes – kerkon qe te ardhurat dhe shpenzimet per gjenerimin e ketyre te ardhurave duhet te kryhen ne te njejten periudhe kontabile.

*Operacionet jo periodike:
Operacionet e Nderprera*

Kriteret e Operacioneve te Nderprera

Operacionet e Nderprera i referohen shitjes, heqjes dore nga nje segment i caktuar i biznesit.

- ❑ Segmenti duhet te jete nje linje e vecante e biznesit
- ❑ Mjetet dhe operacionet e tij duhet te jene te dallueshme nga mjetet dhe operacionet e tjera.
- ❑ ***Duhet bere dallimi i:***
- ❑ Rezultateve operacionale te segmentit si dhe shijes se aktiveve te segmentit.

Raportimi i Operacioneve te Nderprera

Ka dy data te rendesishme ne raportimin e operacioneve te nderprera:

- Data e Vleresimit dhe Matjes
- Data e Shitjes/Heqjes Dore

Data e vleresimit eshte data kur menaxhimi merr persiper te planifikoje shitjen e segmentit.

Dhe data e shitjes eshte data kur shitja e segmentit realizohet.

Implikimi analitik: Analiza eshte e drejtperdrejte - operacionet e nderprera nuk ndikojne ne te ardhurat neto nga operacionet.

**Operacionet joperiodike:
Operacionet e jashtezakonshme**

Operacionet e Jashtezakonshme

- **Operacionet e Jashtezakoshme:**

Jane operacione **materiale** jo te zakonshme te cilat **ndryshojne shume** nga aktivitetet tipike te biznesit.

Operacionet e jashtezakonshme duhet te plotesojne **dy kushte:**

- ❖ Duhet te jene jo te zakonshme **dhe**
- ❖ Duhet te jene jo frekvente

Implikimi Analitik: Edhe pse operacionet e jashtezakonshme nuk ndikojne tek e ardhura neto nga operacionet, analisti duhet ti rishikoje ato me qellim qe te vendose nese pjese e tyre duhet te merret parasysh kur parashikohen te ardhurat.

Operacionet e Jashtezakonshme: Cfare ato nuk jane

- Humbjet nga write-down ose write-off e llogarive te arketueshme dhe inventareve.
- Fitimet dhe humbjet nga kurset e kembimit.
- Fitimet dhe humbjet nga abandonimi i pronave te perdorura ne biznes.
- Efektet e grevave.
- Ndryshimet dhe rregullimet e kontratave afatgjata.

Operacionet e Pazakonta ose jo te Shpeshhta

- Operacione te cilat jane jo te zakonshme OSE jo frekvente por jo te dyja se bashku.
- Raportohen, para taksave dhe para te ardhurave neto nga operacionet e vazhdueshme.

Implikimi Analitik: Edhe pse operacionet jo te zakonshme ndikojne tek e ardhura neto nga operacionet, analisti duhet ti rishikoje ato me qellim qe te vendose nese ato duhet vertet te perfshihen kur parashikojme te ardhurat.

Operacionet e Pazakonta ose jo te Shpeshhta

- Fitime ose humbje nga heqja/shitja e nje segmenti te nje biznesi (kostot e mbylljes se fabrikes etj.)
- Fitime ose humbje nga shitja e aktiveve ose investime ne kompani te tjera.
- Provigjone per rregullime mjedisore.
- Dertime te aseteteve (heqje nga bilanci ose zvogelim i vleres se tyre per shkak te demtimit) dhe kosto ristrukturimi.

Operacionet Joperiodike:

***Efektet Kumulativ i Ndryshimeve
ne Metodave Kontabilitetit***

Ndryshimet ne Metodatat e Kontabilitetit

Nje ndryshim ne metodat e kontabilitet rezulton kur:

- Eshte adoptuar nje parim i ri i cili ndryshon nga ai i perdorur.
- Efekti i ndryshimit duhet te paraqitet ne pasqyre pas operacioneve te jashtezakonshme.
- Nje ndryshim ne parimin e perdorur duhet te dallohet nga nje ndryshim ne menyren e llogaritjes apo te vleresimit.
- Nje shembull eshte ndryshimi nga metoda e vleresimit te inventarit FIFO tek LIFO.

Struktura e Kapitalit

Per te kuptuar llogaritjen e fitimit per akson duhet te kuptojme strukturen e kapitalit te kompanise:

- *Strukture e thjeshte* – kur struktura e kapitalit nuk permban letra me vlere te konvertueshme ne aksione te zakonshme.
- *Struktura komplekse* – kur struktura e kapitalit permban letra me vlere te konvertueshme ne aksione te zakonshme, si obligacione te konvertueshme, aksione preferenciale te konvertueshme, opsione mbi aksionet e zakonshme.

Fitimi per Aksion (EPS)

- Fitimi per aksion eshte nje indikator shume i rendesishem per biznesin.
- Fitimi per aksion (baze), ne rastet e strukturese se thjeshte te kapitalit llogaritet si raport:

Te ardhura neto - dividendin e aksioneve te preferuara
Mesatarja ponderuar e aksioneve ne qarkullim

- Fitimi per aksion duhet paraqitet per cdo seksion te pasqyres se ardhurave.

Fitimi per Aksion(EPS)

- Dividendet e aksioneve preferenciale zbriten nga fitimi neto, pasi EPS duhet ti referohet vetem fitimeve qe jane disponibel per aksioneret e zakonshem.
- Mesatarja e ponderuar e aksioneve te zakonshem qe jane ne qarkullim eshte numri i aksioneve ne qarkullim gjate vitit te ponderuara me pjesen e vitit qe ato kane qene ne qarkullim.

Fitimi per Aksion(EPS)

- Fitimi per aksion i zvogeluar (Dilutive EPS).
- Fitimi per aksion (i zvogeluar), ne rastet e strukturese komplekse te kapitalit llogaritet si raport:

*Fitimi neto i rregulluar ne dispozicion te aksioneve te zakonshem
Mesatarja e ponderuar e aksioneve te zakonshme dhe aksioneve
potenciale ne qarkullim*

- EPS e zvogeluar reflekton maksimumin e zvogelimit te EPS Baze

Fitimi gjithëpërfshires
– te gjitha ndryshimet ne kapitalin e vet
duke perjashtuar investimet ne kapital.

Fitimi Gjitheperfshires

- Fitimi gjitheperfshires mund te paraqitet ne nje pasqyre te vecante te te ardhurave gjitheperfshirese.
- Pasqyre e kombinuar e pasqyres se te ardhurave dhe pasqyres se te ardhurave gjitheperfshirese.
- Ose pjese e pasqyres se Kapitalit te Vet.

Fitimi Gjitheperfshires

Sipas GAAP kater zera trajtohen si fitime te tjera gjitheperfshirse .

- Rregullimet nga konvertimi i pasqyrave financiare ne monedhen e kompanise meme. Ne konsolidimin e pasqyrave financiare te filialeve jashte vendit efekti i konvertimit te aktiveve dhe detyrimeve me kursin e kembimit korent perfshihen si fitime / humbje te tjera gjitheperfshirse.
- Fitimet ose humbjet e perealizuara ne letrat me vlere derivative te mbajtura per mbrojtje.
- Fitimet ose humbjet e perealizuara nga investimet ne letrat me vlere te mbajtura per shitje.
- Ndryshimet ne statusin e fondit te planeve te pensioeneve me benefite te percaktuara.

Analiza e Pasqyres se te Ardhurave

Analiza e matjes se thjeshte kryhet duke llogaritur cdo ze te pasqyres se te ardhurave si perqindje me te ardhurat nga shitja. Analiza e matjes se thjeshte thjeshton:

- Krahasimin ne periudha te ndryshme kohe si dhe
- Krahasimin midis kompanive te madhesive te ndryshme.

Analiza e Matjes se Thjeshte

	A	B	C
Shitjet	10,000,00	10,000,000	2,000,000
Kosto e mallrave te shitura	3,000,000	7,500,000	600,000
Fitimi Bruto	7,000,000	2,500,000	1,400,000
Shpenzimet adminsitrative	1,000,000	1,000,000	200,000
Shpenzimet e kerkimit dhe zhvillimit	2,000,000	-	400,000
Reklammat	2,000,000	-	400,000
Fitimi operativ	2,000,000	1,500,000	400,000

Analiza e Matjes se Thjeshte

	A	B	C
Shitjet	100%	100%	100%
Kosto e mallrave te shitura	30%	75%	30%
<i>Fitimi Bruto</i>	70%	25%	70%
Shpenzimet adminsitrate	10%	10%	20%
Shpenzimet e kerkimit dhe zhvillimit	20%	0%	20%
Reklammat	20%	0%	20%
Fitimi operativ	20%	15%	20%

Analiza e Raporteve Finaniare

Raportet e kthimit (perfitueshmerise) operacionale:

- ❖ Raporti i marzhit te fitimit bruto mat % qe ze fitimi bruto tek shitjet.

$$\text{Marxhi i fitimit Bruto} = \text{Fitmi Bruto} / \text{shtitjet}$$

Implikimi analitik: Nje raport i ulet i marzhit te fitimit bruto eshte shume shqetesues, pasi ai tregon se firma prodhon me kosto te larta ne krahasim me cmimin e produktit.

Analiza e Raporteve Finaniare

Raportet e kthimit (perfitueshmerise) operacionale:

- ❖ Raporti i marxhit te fitimit operativ mat % qe ze fitimi operativ tek shitjet. Fitimi operativ referohet gjithashtu si fitimi para interesave dhe taksave (EBIT).

$$\text{Marxhi i fitimit operativ} = \text{Fitmi operativ} / \text{shitjet}$$

Implikimi analitik: Nje raport i ulet i marxhit te fitimit operativ eshte gjithashtu shume shqetesues, pasi ai tregon se firma ka nje mbulim jo te mire te kostove te prodhimit dhe te shpenzimeve te tjera operacionale.

Analiza e Raporteve Finaniare

Raportet e kthimit (perfitueshmerise) operacionale:

- ❖ Raporti i fitimi neto mbi shitjet mat % qe ze fitimi neto tek shitjet. Fitimi neto i referohet vetem fitimit neto nga operacionet e zakonshme te biznesit duke perjashtuar fitimet qe vijne nga operacione jo te zakonshme te biznesit.

$$\text{Marxhi i fitimit neto} = \text{Fitimi neto} / \text{shitjet}$$

Implikimi analitik: Nje raport i ulet i fitimit neto mbi shitjet tregon se cmimi eshte shume afer koshtos mesatare totale te produktit. E ardhmja e firmes nuk eshte optimiste.

RENDESIA E PASQYRES SE BILANCIT

Pasqyra fillestare per te analizuar pozicionin financiar te nje kompanie eshte bilanci.

Rendesia e Pasqyres se Bilancit

Bilanci ju siguron perdoruesve informacion:

- Mbi burimet ekonomike (aktivet) e kompanise.
- Mbi burimet financiare (te kapitalit) te saj (kapitali i vet dhe detyrime/borxhi).
- Siguron informacion rreth kapacitetit te fitimeve te ardhshme te aktiveve te kompanise.
- Mbi flukset e parase qe mund te vijne nga llogarite e arketueshme dhe inventaret.

Komponentet dhe Formati i Bilancit

- ***Aktivet (A) jane burimet e zoteruara (kontrolluara) nga kompania si rrjedhim i ngjarjeve te shkuara dhe nga pritjet te rrjedhin perfitimet e ardhshme ekonomike te kompanise.***
- ***Detyrimet (L) perfaqesojne detyrimet e kompanise qe kane rrjedhur si pasoje e ngjarjeve te shkuara, shlyerja e te cilave rezulton si nje fluks dales i perfitimeve te ardhshme ekonomike te kompanise.***
- **Kapitali i vet (E) Gjeresisht i njohur si kapitali aksioner, percaktohet duke zbritur nga totali i aktiveve detyrimet e kompanise dhe matematikisht tregohet me ekuacionin e meposhtem:**

$$\mathbf{A = L + E \text{ ose } A - L = E}$$

Kufizimi i Bilancit

- Kufizimet e bilancit lidhen kryesisht me menyren se si maten aktivet dhe detyrimet.

Aktivet

Standartet e raportimit financiar i perkufizojne aktivet si burime te kontrolluara nga kompania qe rrjedhin si rezultat i ngjarjeve te shkuara nga te cilat pritet te rrjedhin perfitimet e ardhshme.

Aktivet duhet te njihen si te tilla ne kontabilitet dhe rrjedhimisht ne pasqyrat financiare vetem nese:

- Ka mundesi qe cdo perfitim i ardhshem ekonomik qe vjen nga nje ze i aktivitet do te rrjedhe ne kompani.
- Zeri i aktivitet ka nje kosto ose vlere qe mund te matet me siguri.

Aktivet qe gjithmone perfshihen ne bilanc:

- Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare
- Inventaret
- Llogari te arketueshme
- Shpenzime te parapaguara
- Aktive financiare
- Taksa te shtyra aktive
- Toka, fabrika dhe makineri

Aktive jo te qendrueshme:

- Investime te llogaritura duke perdorur metoden e kapitalit
- Te drejta nga burime natyrore
- Aktive te mbajtura per shitje

Detyrimet

Detyrimet perkufizohen si sakrificia te mundshme te perfitimeve ekonomike te adhshme te cilat rrjedhin nga obligimet e tanishme te kompanise. Obligimet e tanishme te kompanise kane lindur si rezultat i ngjarjeve te shkuara dhe e detyrojne kompanine te transferoje aktive ose tu siguroje sherbime kompanive te tjera ne te ardhmen.

Ndryshe nje detyrim pershkruhet si:

- Shumat e arketuara te cilat nuk jane raportuar si nje e ardhur ne pasqyren e te ardhurave dhe/ose do te duhet te ripaguhen (p.sh. deftesa per tu paguar).
- Shuma qe jane raportuar si shpenzime ne nje pasqyre te ardhurash por nuk jane paguar (p.sh. llogari per tu paguar, dhe taksa per tu paguar).

Detyrimet e perfshira ne pasqyren e bilancit:

- Hua bankare/deftesa per tu paguar
- Llogarite e pagueshme
- Provigjonet
- Te ardhura te pafituara (te marra ne avance)
- Detyrime financiare
- Detyrime te tjera per tu paguar
- Taksa te shtyra pasive

Kapitali i Vet

Kapitali i vet perfaqeson ate pjese qe i perket pronareve ose aksionereve te nje biznesi. Kapitali eshte interesi i mbetur i aktiveve te nje njesie pasi i jane zbritur detyrimet, dhe shpesh i referohemi si vlera e aktiveve neto:

$$\mathbf{Kapitali\ i\ Vet = Aktive - Detyrime}$$

Karakteristikat qe duhet te kete Kapitali i Vet

- Ai duhet te jete i qendrueshem.
- Nuk duhet te imponoje shpenzime fikse te detyrueshme kundrejt fitimeve (ne rastin e bankave).
- Duhet te lejoje perparesi ligjore te drejtave te kreditoreve.

Dallimi midis konceptit korrent dhe jokorrent

- Aktivet te cilat priten te likuidohen ose perdoren brenda nje viti ose nje cikli operimi te biznesit, (cilado qofte me mire), klasifikohen si aktive korrente (afat shkurtra).
- Aktivet te cilat nuk pritet te likuidohen ose perdoren brenda nje viti ose nje cikli operues te biznesit, (cilado qofte me mire), klasifikohen si aktive jokorrente (afat gjata).

Bazat matese te aktiveve dhe detyrimeve:

- **Vlera e drejte** Vlera e drejte eshte shuma me te cilen nje aktiv mund te shkembehet ose detyrim mund te shlyhet ne nje trasaksion midis dy paleve te mireformuara dhe te gatshme per kryerjen e transaksionit.
- **Kostoja historike.** Kostoja historike e nje aktivi ose detyrimi eshte kostoja e tyre ose vlera e brendshme e saj ne momentin e blerjes, duke perfshire cdo kosto te blerjes dhe/ose te pergatitjeve per blerjen.

Vlera e Aktiveve

Vlera e nje kompanie eshte nje funksion i shume faktoreve, duke perfshire flukset monetare te ardhshme qe priten te gjenerohen nga kompania dhe kushtet aktuale te tregut.

Bilanci siguron informacion te rendesishem rreth vleres se disa aktiveve dhe informacion rreth flukseve monetare te ardhshme por nuk paraqet vleren e kompanise si te plote.

Formati i Bilancit

Bilanci (000)	20X7	20X6
Aktivet		
Aktive korrente	€20,000	€16,000
Mjete monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare	3,000	2,000
Letra me vlere te tregetueshme	3,000	4,000
Llogari te arketushme	5,000	3,000
Inventare	7,000	6,000
Aktive te tjera korrente—shpenzime te parapaguara	2,000	1,000
Aktive jokorrente	53,000	27,000
Toka, fabrika dhe makineri	35,000	20,000
Emri i mire	5,000	1,000
Aktive te tjera	3,000	1,000
Investime jokorrente	10,000	5,000
Aktive totale	€73,000	€43,000

Formati i Bilancit

Bilanci (000)	20X7	20X6
Detyrimet korrente dhe kapitali i vet		
Detyrime korrente	€14,000	€7,000
Llogari per tu paguar	5,000	2,000
Deftesa per tu paguar	3,000	1,000
Pjese korrente e huave jokorrente	2,000	1,000
Takse korrente per tu paguar	2,000	2,000
Detyrime rrjedhese	1,000	500
E ardhur e pafituar	1,000	500
Detyrimet jokorrente	37,000	16,000
Hua jokorrente	30,000	10,000
Taksa te shtyra	6,000	5,000
Provigjione jokorrente	1,000	1,000
Detyrime totale	51,000	23,000
Kapitali i vet	22,000	20,000
Kapital aksionesh	10,000	10,000
Aksione preferenciale	2,000	2,000
Prim aksionesh (te paguara ne kapital)		
Rezerva te tjera (fitime apo humbje te perealizuara)	1,000	
Fitime te pashperndara	9,000	8,000
Aksione te vetat re riblera (aksione thesari)		
Totali i detyrimeve dhe kapitali i aksionereve	€73,000	€43,000

Formati i Bilancit

Bilanci (000)	20X7	20X6
Aktivet		
Aktive korrente	24,7	37,2
Mjete monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare	4,1	4,7
Letra me vlere te tregetueshme	4,1	9,3
Llogari te arketueshme	6,8	7,0
Inventare	9,6	14
Aktive te tjera korrente—shpenzime te parapaguara	2,7	3,2
Aktive jokorrente	72,6	62,8
Toka, fabrika dhe makineri	47,9	46,5
Emri i mire	6,8	2,3
Aktive te tjera	4,1	2,3
Investime jokorrente	13,7	11,6
Aktive totale	100%	100%

Formati i Bilancit

Bilanci (000)	20X7	20X6
Detyrimet korrente dhe kapitali i vet		
Detyrime korrente	19.2	16.3
Llogari per tu paguar	6.8	4.7
Deftesa per tu paguar	4.1	2.3
Pjese korrente e huave jokorrente	2,7	2,3
Takse korrente per tu paguar	2,7	4,7
Detyrime rrjedhese	1,4	1,2
E ardhur e pafituar	1,4	1,2
Detyrimet jokorrente	50.7	37.2
Hua jokorrente	41.1	23.3
Taksa te shtyra	8,2	11,6
Provigjione jokorrente	1.4	2.3
Detyrime totale	69.9	53,5
Kapitali i vet	30,1	46,5
Kapital aksionesh	13,7	23,3
Aksione preferenciale	2,7	4,7
Prim aksionesh (te paguara ne kapital)		
Rezerva te tjera (fitime apo humbje te perealizuara)	1,4	
Fitime te pashperndara	12.3	18.7
Aksione te vetat re riblera (aksione thesari)		
Totali i detyrimeve dhe kapitali i aksionereve	100%	100%
		53

Analiza e Raporteve te Bilancit

Raportet e likuiditetit

☉ Masin aftesine e kompanise per te mbuluar detyrimet korente (afatshkurtra)

1. Raporti korent-eshte matesi me i njohur i likujditetit:

$$\text{Raporti korent} = \text{Aktive A.shkurtra} / \text{Pasive A.shkurtra}$$

Impikimi analitik: Sa me i larte raporti korent aq me shume mundesi ka kompania te paguaje detyrimet afat shkurtra. Nje raport korent me i vogel se 1 do te thote qe kompania ka kapital qarkullues negativ dhe se eshte duke kaluar krize likujditeti .

Analiza e Raporteve te Bilancit

- 2.** Prova acide (raporti i shpejte) –eshte nje raport me konservativ se raporti korrent pasi ne llogaritje nuk perfshihet inventari ose aktive te tjera te cilat nuk jane shume likuide.

$$\text{Prova acide} = (\text{Aktive A.Sh- Inventari}) / \text{Pasive A.Shkurtra}$$

Implikimi Analitik: Prova acide dhe raporti korent ndryshojne vetem ne likuiditetin e supozuar per shlyerjen e detyrimeve afatshkurta.

Analiza e Raporteve te Bilancit

◎ Raportet e Leves Financiare (Risku Financiar)

1. Raporti i borxhit mbi kapitalin e vet- mat perdorimin e burimeve te financimit me kosto fikse:

$$\text{Borxhi mbi kapitalin e Vet} = \text{Borxhi afatgjate} / \text{Kapitalin e vet}$$

Implikimi Analitik: Rritja ose zvogelimi i ketij raporti sugjeron nje ulje ose ngritje te perdorimit te borxhit si burim financimi.

Analiza e Raporteve te Bilancit

◎ Raportet e Leves Financiare (Risku Financiar)

2. Raporti i borxhit total mat perdorimin e borxhit afatshkurter dhe afatgjate si burim financimi:

$$\text{Raporti i borxhit total} = \text{Borxhi total} / \text{Totalin e pasiveve}$$

Implikimi Analitik: Rritja ose zvogelimi i ketij raporti sygjeron nje ulje ose ngritje te perdorimit te borxhit si burim financimi.

Analiza e Raporteve Financiare

Raportet financiare ju sherbejne qellimeve te meposhtme:

- Sigurojne nje depertim ne marredheniet mikroekonomke brenda nje kompanie qe e ndihmojne analistin te projektoje fitime dhe flukse te lira te parase (te cilat jane te nevojshme per te percaktuar vleren dhe kredibilitetin e kompanise).
- Ato sigurojne nje depertim ne fleksibilitetin financiar te kompanise, e cila eshte aftesia e saj per te siguruar mjetet monetare te nevojshme per te arritur obligimet financiare ose per te bere blerjet e aktiveve edhe nese dalin ngjarje te papritura.
- Ato sigurojne menyra per te vleresuar aftesine e manaxhimit

Kufizimet e Analizes se Raporteve

- ***Perdorimi i metodave kontabile alternative.*** Metodot kontabile luajne nje rol te rendesishem ne interpretimin e raporteve financiare.
- ***Homogjeniteti i aktiviteve operuese te kompanise.*** Shume kompani diversifikohen me ndarje duke operuar ne industri te ndryshme. Kjo e ben te veshtire per te gjetur raporte industrie te krahasueshme per tu perdorur per qellime krahasimi.
- ***Nevoja per te percaktuar nese rezultatet e analizes se raportit jane reciprokisht te qendrueshme.*** Nje grup raportesh mund te tregoje nje problem dhe nje grup tjetër raportesh mund te tregoje qe ky problem eshte afat shkurter ne natyre.
- ***Nevoja per te perdorur gjykim.*** Kur perdorin analizen e raporteve analisti duhet te perdore gjykimin.